

# Gjakmarrje apo biznes gjaku

(Dërguar më: 31/01/09) Nga Flutura Acka

Në verën e vitit të shkuar, një regjisor holandez më kërkoi ta shoqëroja për një dokumentar televiziv që ai këmbëngulte të e ngujuar dhe ndikimin e sotëm të Kanunit në Shqipëri.

Si shkrimtare që i kisha kushtuar një prej romaneve të mi kësaj teme, “Kryqi i harresës” i botuar në vitin 2004, isha shumë e interesuar të dija ç’po ndodhte ende me “personazhet” e mi dhe a kishte ndryshuar diçka nga koha kur e kisha publikuar veprën time, vepër e thukët e që ve gishtin mbi këtë plagë shumë të rëndë.

Në disa prej familjeve të ngjuara ku hymë, varfëria ishte aq e dukshme, sa ishe i detyruar të refuzoje edhe kafënë e zakonshme të zezë. I ruajmë paratë, ato të pakta para nga pensionet e pleqve, të ndihmave nga miq e shoqata, për të paguar Pajturesit e gjakut. Pajturesit e gjakut tashmë janë shtuar shumë në zonat me probleme si këto, disa madje prej tyre kanë krijuar edhe kupola, kanë ndihmësa e sekretarë për punërat e tyre, me një fjalë, kanë krijuar me kinse “bizneset” e tyre të pajtimit. Përveç një pjese shumë të nderuar dhe që vërtet janë vullnetarë dhe bëjnë një mision human dhe duhen dalluar, emrat e të cilëve njerëzit i përmendin me respekt, pjesa tjetër merren “biznesin e gjakut” në vend të pajtimit të gjakmarrjeve.

Njërin prej tyre rastisëm ta takonim edhe ne. Emri nuk më kujtohet, por dukej shumë i njohur në zonën e Shkodrës. Ne trokitëm në shtëpinë e tij dhe na u desh të prisnim në oborr nga shihej një vilë e bukur, e ndërtuar rishtas, me ballkone, dritë e pemë. Nga jashtë ti e kuptoj se kamja aty kishte dukë. Më në fund, pajtimtari erdhi dhe unë, ndryshe nga regjisori që ishte i interesuar për çështje statistikash e moshash, vërejtja me hollësi portretin e tij. I veshur shik i gjithi me të bardha, madje edhe këpucët, i mbajtur mirë dhe me shëndet që tregonte mirëqenie, ai erdhi duke ngarë një motor. Kishte qenë për të takuar ca miq te Kafja e Madhe. Ishte shumë “i zënë” me gjaqet, gjë që na e shpjegoi duke shfletuar një dosje të madhe ku kishte gjithfarë dokumentesh të ngjuarish e fëmijësh të kërcënuar.

A ka ndonjë rast nga ajo dosje, apo nga dosjet e pajturesve të tjerë si ai, të denoncuar në polici? Kjo ishte pyetja që i bëmë dhe që do ta bënte kushdo që do të qe aty. Jo. Këto nuk janë punë për shtetin, me Shtet nuk zgjidhet gjë, kemi vetëm punë burrash. Ka raste kur “burrat” nuk i bindin dot “burrat” e krahut tjetër, dhe gjaqet zgjasin me vite. Këto janë çështje shumë të vështira dhe i zgjidh vetëm Kanuni, ndaj Kanuni na duhet, pata dëgjuar të thoshte një prej drejtuesve të këtij sektit pajtimtarësh, që mbahet me fonde që Evropa na sjell për të na shpejtuar integrimin në të. Në konfidencë njëri prej njerëzve që na shoqëronte, na shpjegoi të gjithë procedurën e pajtimit, se si shtroheshin dreka e darka për burrat dhe se si pajturesi, në varësi të “fuqisë pajtuese” të tij, paguhej deri në 1000 lekë ora (!) Ma do mendja se këtë pagë do ta kishin zili edhe interpretët më të mirë në Tiranë, me gjithë përvojën dhe shkollimin e tyre. Dhe familja që dëshiron ta mbyllë gjakun, paguan se kërkon të shpëtojë një herë e mirë nga e keqja që e ka zënë. Nëse nuk kanë para, marrin hua, pajturesi edhe pse “vullnetar”, duhet paguar. Dhe fëmijët, pas portave të anuara në kthinat e tjera, presin duke luajtur, pa e ditur se burrat e mbledhur matanë po vendosin fatin e tyre. Këto ditë në kronikat televizive njëri prej drejtuesve të policisë në Shkodër tha se nuk ka denoncime të rasteve të tilla të ngujimit të fëmijëve. Pavarësisht kësaj, jashtë atij Nderi (atij farë Nderi të shëmtuar kanunor që kërkon të lajë kokë me kokë, që ngujon

gra e fëmijë!), shteti e ka fare të lehtë t'i evidentojë rastet. Ka një tjetër ligj, ai i arsimit të detyruar, me të cilin drejtuesit dhe policia në Shkodër e gjetkë, mund të veprojnë, të kërkojnë ku janë këta fëmijë nëse vërtet i ka të regjistruar ata dhe t'i detyrojnë të shkollohen. Nëse jo, ne do të rrisim një brez mes urrejtjesh, të paarsimuar, të ngarkuar me faje të paqenë dhe që rrezikon t'i kthejë vetë ata nesër në vrasës, pikërisht për shkak të këtij ngujimi të gjatë. Askush nuk mund të thotë një shifër të saktë se sa fëmijë të ngjuar ka në Shqipëri. Pajtuesit thonë se fëmijët e ngjuar janë shumë (shumë!). Ky është fundja interesi i tyre, puna e tyre. Specialistët e së drejtës zakonore dhe ata që hartojnë draftet e udhës për në Evropë, thonë se janë pak (pak!). Por, sado që të jetë numri i tyre, ngujimi i fëmijëve dhe të privuarit qoftë dhe nga drita e diellit, është një njollë e errët barbarie e një shoqëri si jona, që kërkon të jetë pjesë e qytetërimit.

E në fakt, kush merret me rastet e fëmijëve të ngjuar? Të ashtuquajturat shoqata të drejtash të njeriut, të drejtave dhe shansesh të barabarta, të të drejtave të grave dhe fëmijëve, të tilla ka shumë, nuk e kanë realisht objekt të tyre këtë problem. Unë nuk di të ketë ndonjë shkelje më të madhe të së drejtës, se sa e drejta për të jetuar, nga e cila ata janë të privuar. Të vetmin njeri që gjeta të shqetësuar për këta fëmijë, që bariste sa në një shtëpi e ngjuar te tjetra, duke u dhënë "besë" familjeve, duke i mbledhur dhe marrë një pjesë të tyre nën kujdes për shkollimin e tyre në Qendrën e fëmijëve të ngjuar në Poliçan, ishte një mësuese dukagjinase, Liljana Luani. Sot dhe gjithë ditën kam dëshirë të besoj se ajo vërtet është e përkushtuar në misionin e saj. Dhe do të besoj sa kohë askush nuk më provon të kundërtën. Edhe fakti se ajo ka denoncuar në mënyrë të vazhdueshme grabitjen e fondeve të rikonstruktimit e Qendrës, ngritjen e shoqatave paralele fëmijësh në Poliçan, duke rendur nëpër shoqata humanitare për t'u siguruar bukën e përditshme atyre fëmijëve, më thotë se ajo nuk ka ndonjë pikë të errët, përtej dëshirës së saj për t'i parë ata fëmijë, të cilët i ka kuruar vetë, të realizuar, të gëzuar dhe larg barbarisë me të cilën i ka mallkuar fati.

Por duket se Liljana Luanit, i gjithë përkushtimi i saj, mund t'i kthehet në bumerang. Sepse ajo ka kurajën të denoncojë pushtetarë që duket se janë hallka të një zinxhiri partiak. Duar që lajnë njëra-tjetrën dhe bashkë lajnë fytyrën. Madje aq partiak duket ky zinxhir, sa edhe drejtuesit e rinj të qendrës parapëlqejnë t'i emërojnë sërish partiakë, si për të paragjykuar faktin se ai vend duhet të jetë një post (jo detyrë humane!) për t'u vjelë. Nga gjithë ky teatër që vazhdon prej vitesh dalin shumë pyetje, që kërkojnë përgjigje nga njerëz që kanë bërë skenarin dhe lojën në të. Madje edhe ne spektatorët nuk mund të jemi më shpërfillës.

Kur regjisori holandez, i cili për të plotësuar dokumentarin e tij, e ndoqi fatin e fëmijëve deri në Poliçan, u kthye nga andej, ishte i tronditur. Në ato kushte, tha, edhe kafshët refuzojnë të jetojnë. Djali pesëmbëdhjetë vjeçar i familjes Ndrevataj, i kishte thënë: Përse ta bëj shkollën, kur e di se do të vritem! Unë do të vritem për gjakun, unë jam më i madhi i fëmijëve, është radha ime. Nga të hollat që kishte pasur në xhep, holandezi i prekur nga gjendja aty, kishte dhënë njëqind euro dhe fëmijët e Qendrës atë natë kishin bërë festë.

Kanë kaluar disa muaj nga ajo kohë. Viti i ri shkollor, që nuk mund të quhet më i ri, e ka mbyllur semestrin e parë dhe fëmijët e Qendrës janë ende pa libra. Në një nga programet televizive të ditëve të fundit, drejtorin e punëve dhe çështjeve sociale në Ministrinë me të njëjtin emër, nga varet tashmë qendra, e dëgjova të thoshte se kishin bërë prej kohësh gjithçka për mirëmbajtjen e Qendrës së fëmijëve të ngjuar. Unë, si dhe çdo shqiptar, nuk e di se cilën nga këto të vërteta të besojë. Gjithsesi, prokurorët e çështjes në fjalë, edhe pse ca ngadalë, do të arrijnë në përfundimet e tyre, shpresojmë të pandikuar nga asnjë presion politik, për ta "shfajësuar" sadopak shoqërinë shqiptare

nga një prej mëkateve të saj: shpërfilljen ndaj fëmijëve të ngjuar... të Poliçanit...  
dhe jo vetëm të tij.

**(s.g/GazetaShqiptare/BalkanWeb)**